



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA “ALBPETROL” SH.A.

DREJTORIA E PROKURIMIT DHE ANKANDIT

Nr. _____ Prot.

Patos, më ___/ 10/2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje oksigjen,acetilen”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): [24111900-4](#) – oksigjen

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,126,870 (dy milion e njëqind e njëzet e gjashtë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Albpetrol sha ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kapaciteti ligjor plotësohet duke dorëzuar dokumentat sipas Kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se se 40 % vlera e fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosija e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP dhe ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 20 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kerkohen të paraqiten:

Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

OSE

Ne rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 55, pika 4, germa b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën ISO 9001:2015 ose e përditësuar mbi “Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtyre kërkesave AK kërkon të sigurohet që ofertuesit

ushtrjnë aktivitetin dhe janë të certifikuar në përputhje me kërkesat e menaxhimit cilësisë dhe ky kriter i vendosur është në përputhje të plotë me objektin e prokurimit

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikaten ISO OHSAS 18001:2007 ose ISO 45001:2018 mbi "Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë të punonjësve", ose ekuivalente (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtyre kërkesave AK kërkon të sigurohet që ofertuesit ushtrojnë aktivitetin dhe janë të certifikuar në përputhje me kërkesat për menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë në punë të punonjësve dhe ky kriter i vendosur është në përputhje të plotë me objektin e prokurimit.

2.3.4. Flete-analizat ose raport-analizat të lëshuara nga Institucione të akredituar nga DPA ose nga organizma Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, ose nga prodhuesi, që të vertetohet përputhshmeria e mallit të ofruar (oksigjen, acetilen) me specifikimet teknike të kerkuara

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 40, pika 6 gërma c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Ky kriter shërben për të treguar se malli i ofruar është në përputhje me standartin dhe plotëson specifikimet teknike të kërkuara.

2.3.5 Operatori ekonomik në rast se nuk është prodhues, duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për mallrat e kerkuara. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij..

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 40, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë dhe AK të sigurohet se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe se mallrat e ofruara janë konform të gjitha standardeve dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushës pranë Autoritetit Kontraktor të cilët kanë njohuri të posaçme për objektin e prokurimit. *Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Njësia e Prokurimit: